



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 539/ Prot.  
3

Durrës, më 20.04.2020

VENDIM

Nr. 44, datë 20.04.2020

PËR

**"MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSIVE, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS".**

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 20.04.2020,

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për studentë të cilët vijojnë studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve dhe vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë sipas listës bashkëlidhur të hartuar nga komisioni i verifikimit të bursave, 13 studentë, efekti financiar 865000 lekë.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
  - o Administratori
  - o Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**

**Ilirjana NANO**

